



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/04-48546 dt. 19/09/ 2022

Procesverbali i Dëgjimeve Publike për listën e Projekteve kapitale për Buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitin 2024-2025

Dëgjimi buxhetor është mbajtur në bashkësinë lokale të Baicës me fshatin (Abri,
Tërdec, Baicë, Krajkovë, Damanek)



Njoftimi për organizimin e dëgjimeve publike për listën e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025 u bë me dt: 01.09.2022 në ueb faqen e komunës së Drenasit, në këtë vegës: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/neës/ftese-per-degjime-publike-per-listen-e-projekteve-kapitale-per-buxhetin-e-vitit-2023-dhe-projeksioneve-per-vitet-2024-2025/> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton udhëzimi Administrativ si vijon:

Bazuar në nenin 68, paragrafi 68.1 të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Nr.110-6904 i dt. 24.09.2008 dhe Propozim ndryshimin e Statutit të Komunës nr. 112-10030 i dt. 16.02.2018, si dhe Rregullores Komunele për Transparencë nr.i protokollit 12-030-63551 i dt. 30.10.2019 dhe nën organizimin e Kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe Anëtareve të Komitetit për Politikë dhe Financa organizohen 8 dëgjime publike me qytetar për listën e Projekteve Kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhenies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banoret e Komunës së Drenasit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së degjimeve publike me qytetar janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i orarizimit të degjimeve publike në ueb faqen zyrtare të komunës si dhe në rrjetin social facebook, njoftimi në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/neës/ftese-per-degjime-publike-per-listen-e-projekteve-kapitale-per-buxhetin-e-vitit-2023-dhe-projeksioneve-per-vitet-2024-2025/>

Njoftimet përveç që janë publikuar në ueb faqen e Komunës së Drenasit në platformen për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetareve të keshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe EhatsApp.

Fillon cikli i dëgjimeve publike për Projektet Kapitale të buxhetit 2023- 2025

Komuna e Drenasit, përkatësisht Kuvendi Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa në bashkëpunim me Ekzekutivin e Komunës, kanë filluar mbajtjen e dëgjimeve buxhetore me qytetarë për të diskutuar lidhur me listën e Projektet Kapitale për periudhën 2023-2025.

Të enjten me dt. 08.09.2022 në ora 16:00 u mbajt Dëgjimi buxhetor në bashkësinë lokale të Baicës me fshatin (Abri, Tërdec, Baicë, Krajkovë, Damanek) Takimi u mbajt në SHFMU "Migjeni" Baicë.

Këto Dëgjime Buxhetore për Projekte Kapitale janë organizuar nga Zyra e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Takimin e pestë e prezantoi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun Bekim Dobra, ndërsa merrnin pjesë, Nënkryetari i Komunës, Arben Shala, Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, drejtorë të drejtorive komunale, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve dhe qytetarë të tjerë dhe zyrtaret e zyrës së Kuvendit: Zahrie Podrimqaku-Subashi, Liridona Fejza-Ajazi, Erlona Gashi, Asambleistë.

Pjesëmarrës në këtë dëgjim dhe zyrtar komunal ishin gjithsej 35 pjesëmarrës :

- Femra ishin: 12
- Meshkuj: 23

Të gjithë të pranishmit janë pajisur me materialet e nevojshme për të diskutuar. Ata para vetës kanë pasur draft-listën e projekteve kapitale si dhe draft-buxhetin për vitet 2023-2025 dhe pasi kanë paraqitur kërkesat e tyre kanë marrë përgjigje për kërkesat e parashtruara.

Ndryshe, buxheti i përgjithshëm i Komunës për vitin 2023 është 18.156.892.00 euro, ndërsa nga kjo shumë për investime kapitale janë planifikuar 6.335.649.00 euro apo 34.89%.

Takimet për Listën e projekteve kapitale do të zhvillohen më këtë rend dite.

1. Lista e projekteve kapitale për vitet 2023-2025,
2. Prioritete tuaja.

Të pranishmit kanë paraqitur kërkesat dhe nevojat e tyre për të cilat kanë kërkuar të futen si Projektet Kapitale 2023- 2025.

Bekim Dobra, pasi përshëndeti të pranishmit, theksoj se lista e projekteve kapitale është e një rëndësie të veçante për vendbanimet e Komunës së Drenasit andaj ju qytetar, duhet të shfrytëzoni të drejtën tuaj dhe të caktoni prioritet për vendbanimet tuaja në mënyrë që të përcaktohen sa më mirë prioritet tuaja. Këtë rëndësi të veçantë ku do na shërbejë që të përcaktohen prioritetet për vendbanime, lagje, dhe lista e investimeve kapitale të jetë sa më e kompletuar, dhe të i përfshij nevojat e vendbanimeve tona, për të përmirësuar jetën tuaj.

Milaim Hajdari- Kryesues i Kuvendit Komunal, Të nderuar të pranishëm,

Mirë se keni ardhur në këtë takim të thirrur nga Kuvendi i Komunës, në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale.

Jemi mbledhur sot në këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar draft-Listën e Investimeve Kapitale për vitin 2023 dhe projeksionet e investimeve për vitet 2024, 2025. Siç ju tregoj edhe shefi i Zyrës për Informim, Bekimi, kjo listë ende mbetet si draft deri në miratimin e saj në mbledhjen e Kuvendit më së largu me 30 shtator të këtij viti, prandaj është mirë që të

fokusoheni në këtë listë që keni para vetes dhe të jepni propozime, ide konkrete të projekteve që janë me interes të përgjithshëm të vendbanimit që ju përfaqësoni.

Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën për mbajtjen e këtij takimi ndërsa që nga muaji Maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar Qarkoren Buxhetore, kemi ftuar ekspertet, OJQ-të, Shoqërinë Civile dhe profesionistët për të kontribuar në hartimin e këtij dokumenti.

Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë ka bërë publike, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025 dhe draft-Listën e Investimeve Kapitale i ka publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës. Këto dy dokumente janë votuar në mbledhje të Kuvendit dhe na kanë dhënë dritën jeshile për të dalë në diskutim publik, këto dëgjime që po i mbajnë tani, ndaj kërkojë nga ana juaj që të diskutoni reciprokisht me qëllim që të behët një përmbledhje me interes të përgjithshëm për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Presim komente, projekte e ide që të futen në këtë listë sipas mundësive buxhetore, para se i njëjti dokument të miratohet në mbledhje të Kuvendit.

Ju faleminderit shumë që keni gjetur kohën të jeni pjesë e këtij takimi.

Mehmet Zariqi- Fshati Baicë, kërkesat me primare për fshatin Baicë janë:

- Asfaltimi i rrugës i 7 shtëpive të lagjes Mehmeti.
- Rregullimi i ndriçimit publik
- Rregullimi i Kanalizimit
- Furnizimi me ujë të pijes.

Nënkryetari i Komunës-Arben Shala, sa i përket asaj rruge ka mbet në gjysmë shkaku i pengesës së punës nga një qytetar i asaj pjese mirëpo lidhur me kërkesën tuaj për asfaltim të rrugës e kemi lidhur një kontratë me operatorin ekonomik dhe projekti për asfaltimin e rrugëve në qytetin e Drenasit dhe fshatrave do të vazhdoj, por edhe për vitin e ardhshëm kemi planifikuar mjaftueshëm buxhet për tu përfunduar shumica e rrugëve në Komunën tonë,. Ndërsa sa i përket ujit të pijes Komuna e Drenasit është duke punuar intenzivisht në rregullimin e ujësjellësit dhe këtë vit po shpresojmë që shumë fshatra të jenë në sistem të ujësjellësit, nëse nuk dalin telashe në shtrirjen e rrjetit të gypave që janë vendosur vite me pare në fshatra. Është bërë rregullimi i rezervuarve dhe presim që shumë shpejt të bëjmë edhe testimin e këtij projekti, po ashtu ju po e shihni që kemi nda mjete edhe për vitin e ardhshëm për këtë projekt sepse prioritet i qeverisjes Lladrovci është të ju sigurohet uji i pijes për gjithë banorët e komunës, sepse në projektin e realizuar vite me parë, nuk ishin vendosur gypat fare në projekt dhe për këtë arsye është vonuar jetësimi i këtij projekti shumë me rëndësi për qytetarët e komunës.

Samedin Kiqina- Administrator i fshatit Baicë, kërkesat me primare për fshatin Baicë janë:

- Rregullimi i Kanalizimit – lagja Elshani.
- Rregullimi i ndriçimit publik.
- Asfaltimi i disa rrugicave në fshatin Baicë.

Zenë Halilaj- Administrator i fshatit Tërdec, kërkesat me primare për fshatin Tërdec janë:

- Rregullimi i Trotuareve në fshatin Tërdec.
- Rregullimin e shtyllave të betonit të energjisë elektike, 35 shtëpi lagja Halilaj.

Nënkryetari i Komunës se Drenasit- Arben Shala, do t'i marrim parasysh kërkesat tuaja, ndërsa sa i përket shtyllave të betonit të të energjisë elektike duhet të bëni kërkesë tek KEDS.

Enver Hoxha-Administrator i fshatit Damanek, kërkesat me primare për fshatin Damanek janë:

- Ndërtimi i Trotuareve në fshatin Tërdec.
- Rregullimi i ndriçimit publik.

Xhevdet Demaku- Administrator i fshatit Abri e Eperme kërkesat me primare për fshatin Abri janë:

- Rregullimi i Kanalizimit
- Rregullimi i ndriçimit publik.
- Asfaltimi i disa rrugicave
- Furnizimi me ujë të pijes.

Besim Tahiraj, Zyrtar në Infrastrukturë Lokale- sa i përket rrjetit të kanalizimit 95 % e fshatrave do të përfundon rrjeti i kanalizimit apo ashtu edhe ndriçimi publik.

Ramadan Ramaj- Fshati Tërdec, sa i përket fshatit Tërdec infrastruktura është shumë e mirë mirëpo si kërkesë primare për fshatin tonë është:

- Ndërtimi i një fushe sportive në fshatin tonë.
- Fshati jonë ka shumë pengesa në rrugë, kërkoj me i heq ato.
- Administratoret e fshatrave mos të fuzionohen, por të mbesin kështu siç janë.

Nënkryetari i Komunës se Drenasit- Arben Shala, sa i përket pengesave në rrugë kemi lidhur një kontratë me operatorin ekonomik dhe projekti se shpejti do të filloj dhe do t'i eliminojmë ato. Ndërsa sa i përket administratoreve të fshatrave nuk e kemi përcaktuar ne mirëpo është i përcaktuar me udhëzim administrativ.

Arber Haziri, fshati Krajkovë, a do të vazhdojnë punimet gjate këtij viti?

Besim Tahiraj, Zyrtar në Infrastrukturë Lokale- projektet që kemi lidhur një kontratë me operatorin ekonomik do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre.

Rasim Zariqi, fshati Baicë, si kërkesë primare e fshatit tonë është:

- Ndërtimi i një mbikalimi për vetura.
- Rregullimi i asfaltimit të rrugës.

Besim Tahiraj, Zyrtar në Infrastrukturë Lokale- ne e kemi bërë një kontratë me një operator ekonomik dhe se shpejti do të filloj punimet, dhe këtë vit besoj se do ta rregullojmë atë pjesë.

Pasi nuk pati diskutime, kërkesa apo sugjerime të tjera takimi përfundoj rreth orës 16:45 min.

